



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:229206

Datë: 06.03.2024

Numri i dokumentit: 05417288

P.nr.758/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Veli Kryeziu, me bashkëpunëtoren profesionale Albinë Velekinca Sadiku, në çështjen penale kundër të pandehurve: Sh....Z... dhe P.. V... që të dy nga Gjilani, për shkak se kanë kryer veprën penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-ës), duke vepruar sipas të aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, me numra PP.II.nr.1586/2023, të datës 26.10.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datës 22.02.2024, mori dhe shpalli, ndërsa me datë 05.03.2024 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

Ndaj të pandehurve:

I pandehuri Sh.... Z..., nga babai E... dhe nëna S..., e gjinisë A... i lindur më datë..., në Kumanovë, me vendbanim në Gjilan në rr."...", i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, i pa punësuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal

I pandehuri P.... V..., nga babai S.... dhe nëna S..., e gjinisë L..., i lindur më datë, në Gjilan, ku edhe jeton në rr."...", i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, i pa punësuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal

JANË FAJTOR

Sepse me datë 18.07.2023, rreth orës 20:58, në Gjilan, rruga „Mërgimtarët e Gjilanit”, Policia e Kosovës, gjatë patrullimit, ka ndalur të pandehurit dhe gjatë kontrollimit, tek i pandehuri P... V..., brenda, në pakon e cigareve të tij, „Winston” policia ka gjetur substancë narkotike, që sipas testit fushor substanca narkotike ka rezultuar të jetë e llojit „Marihuanë”, me peshë 1.57 gram, ndërsa i pandehuri tjetër Shqiprim Zeneli, është shoqëruar në stacionin policor, ku gjatë kontrollimit, në trup, në të brendshmet i tij, policia ka gjetur substancë narkotike, që sipas testit fushor substanca narkotike ka rezultuar të jetë e llojit „Marihuanë”, me peshë 7.83 gram, e cila sekuestrohet nga ana e policisë, me çka të pandehurit pa autorizim kanë poseduar substancë narkotike të llojit „Marihuanë”.

-Me çka kanë kryer veprën penale, posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 të KPRK-së;

Andaj gjykata në bazë të nenit 4,38,39,40,42,43,69,70,71 dhe 72 të KPRK-ës dhe neneve 242 dhe 364 të KPP-ës, të pandehurve:

JU CAKTON

Të pandehurit **Sh... Z...**, i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej **90 (nëntëdhjetë) ditësh**, ashtu që me pëlqimin e të pandehurit dhe në kuptim të nenit 44 të KPRK-së, të pandehurit, dënimi i shqiptuar me burgim i **ZËVENDËSOHET** me dënim me gjobë në shumën prej **900.00 (njëqindën-euro)€**, si dhe me dënim me gjobë në shumë prej **150 (njëqind e pesëdhjetë-euro)€**, të cilat dënim i njëjti është i obliguar ti paguajë pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, në pesë rata.

Të pandehurit **P... V...**, i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej **60 (gjashtëdhjetë) ditësh**, ashtu që me pëlqimin e të pandehurit dhe në kuptim të nenit 44 të KPRK-së, të pandehurit, dënimi i shqiptuar me burgim i **ZËVENDËSOHET** me dënim me gjobë në shumën prej **600.00 (gjashtëqind- euro)€**, si dhe me dënim me gjobë në shumë prej **100 (njëqind-euro)€**, të cilat dënim i njëjti është i obliguar ti paguajë pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, në pesë rata.

Nëse të pandehurit e lartcekur, nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguajë dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet në dënim me burgim ashtu që 1 (një) ditë burgim do t'i llogaritet për çdo 20 euro, të dënimit me gjobë.

Në bazë të nenit 269 paragrafi 3 të KPRK-ës nga të pandehurit **KONFISKOHET** substanca narkotike e llojit “...., e cila pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë duhet të shkatërrohet nga ana e komisionit të formuar nga kryetari i kësaj gjykate-sektori për ekzekutimin e sanksioneve penale të cilët duhet të përpilojnë procesverbal për shkatërrimin e sendit të konfiskuar dhe të njëjtin duhet t'ia bashkëngjisin lëndës përkatëse.

Obligohen të pandehurit që të paguajnë paushallin gjyqësor veç e veç në shumën prej **20€ (njëzet-euro)**, si dhe shumën prej **30 € (tridhjetë euro)** për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

ARSYETIM

Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 26.10.2023, ka ngritur aktakuzë me numër PP.II.nr.1586/2023, kundër të pandehurve: për shkak se kanë kryer veprën penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 të KPRK-ës.

Më datë 22.02.2024, në këtë gjykatë është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezent prokurorja e shtetit Ilirijana Haziri-Kryeziu, të pandehurit

Në këtë seancë pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit të pandehurit e lartcekur kanë deklaruar se e kanë kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohen dhe se e pranojnë fajësinë për kryerjen e kësaj vepre, duke shtuar se ju i vije keq dhe janë penduar për kryerjen e kësaj vepër e penale, i kanë premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra penale, andaj i kanë propozuar gjykatës që t'ju shqiptoj një dënim më të butë , me ç 'rast gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 242 të KPP-ës, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurve dhe rrjedhimisht shqyrtimit fillestar ka vazhduar me deklarimet e palëve lidhur me dënimin.

Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën kanë qenë prezentë palët e lartcekura gjykata pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilët kanë pranuar fajësinë e të pandehurve për veprën penale për të cilën akuzohen ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 242 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurve nuk është kundërshtuar edhe nga ana e palëve prezentë. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se të pandehurit e kanë kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurve si dhe njoftimit të sajë lidhur me pasojat dhe bene fitet e pranimit të fajësisë, se të pandehurit nuk kanë qenë të detyruar ose të shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojnë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza siç janë: Raporti fillestar i incidentit me nr. të rastit HTN-GJI-123 i datës 18.07.2023, deklarata e të pandehurve, kërkesa për ekzaminimin e substancës narkotike, raporti njoftues për test fushor, vërtetimet mbi sekuestrimin e provave apo pasurisë, të dhënat nga data-baza e policisë dhe prokurorisë për të pandehurit, foto dokumentacioni, raporti i zyrtarit policor Bashkim Ahmet, si dhe shkresat tjera. Po ashtu me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurve gjykata gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se të pandehurit: Shqiprim Zeneli dhe Premtim Vokshi që të dy nga Gjilani, për shkak se kanë kryer veprën penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 të KPRK-ës, si në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Rethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit ka vlerësuar se të pandehurit duhet ti shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej **90 (nëntëdhjetë) ditësh**, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit i është zëvendësuar dënime me burg në dënim me gjobë në shumë prej **900.00 (njëqindën-euro)€**, si dhe me dënim me gjobë në shumë prej **150 (njëqind e pesëdhjetë-euro)€**, si dhe për të pandehurin e dytë i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej **60 (gjashtëdhjetë) ditësh**, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit i është zëvendësuar dënime me burg në dënim me gjobë në shumë prej **600.00 (gjashtëqind- euro)€** si dhe me dënim me gjobë në shumë prej **100 (njëqind-euro)€**, të cilat dënim të njëjtit janë të obliguar ti paguajnë pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, në pesë rata, ngase duke i marrë

parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit, gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69,70,71, dhe 72 të KPRK-së, ashtu që rrethanë lehtësuese për të pandehurit gjykata ka marrë faktin se të njëjtit e kanë pranuar fajësinë për veprën penale të cilat ju vihen në barrë në një fazë të hershme të procedurës, të njëjtit janë penduar dhe kanë shfaqur keqardhje për veprimet e tyre, faktin se të njëjtit kanë premtuar që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale, ndërsa si rrethanë rënduese për të pandehurit gjykata mori për bazë shkallën e përgjegjësisë penale, rrezikshmërinë shoqërore, të cilat vepra penale janë në rritje e sipër, dashjen e të pandehurve për ta kryer veprën penale për të cilën janë shpallur fajtor siç shihet në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurve duhet t'ju shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesës si dhe përgjegjësinë penale të tyre ashtu që me rastin e matjes së dënimit gjykata pati parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 69 të KPRK-ës, ashtu që gjykata mori parasysh shkallën e përgjegjësisë penale në të cilën përfshihet fakti se të njëjtit kanë qenë plotësisht të përgjegjshëm për veprimet e tyre meqenëse të njëjtit në kohën e kryerjes së veprës penale nuk kanë lënguar nga ndonjë sëmundje mendore, faktin se të njëjtit kanë paraqit një shkallë të lartë të vetëdijes dhe dëshirës për ta kryer veprën penale për të cilën janë shpallur fajtorë, po ashtu me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh edhe rrethanat personale të tyre.

Me rastin e matjes së dënimit gjykata është bazuar edhe në rregullat e përgjithshme të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit si në kuptim të nenit 70 të KPRK-ës, ashtu që si rrethanë posaçërisht lehtësuese për të pandehurit gjykata mori pranimin e fajësisë nga ana e tyre, pendimin e tyre, premtimin që në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra të tilla dhe as vepra të tjera, ndërsa si rrethanë rënduese për të pandehurit gjykata mori shkallën e lartë të dashjes të shfaqur nga ana e të pandehurve sepse nga përshkrimi faktik si dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës del se të pandehurit këtë vepër penale e kanë kryer me dashje .

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat dhe në kuptim të nenit 72 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPRK-ës, gjykata të pandehurve ju shqiptoj dënimin brenda kufijve të paraparë ligjor të paraparë si në nenin 73 të KPRK-ës, gjithnjë duke konsideruar se me dënimin e shqiptuar ndaj të pandehurve mund të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës, të cilat konsistojnë në parandalimin e të pandehurve nga kryerja e veprës penale dhe rehabilitimin e tyre, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi konfiskimin

Duke u bazuar në nenin 269 paragrafi 3 të KPPK-ës, gjykata ndaj të akuzuarve të lartcekur ju ka konfiskuar substancën narkotike e llojit ,, , pasi që ky aktgjykim të marrë formën e prerë e njëjta do të shkatërrohet.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurve, gjykata duke u bazuar në nenin 450 paragrafi 1 të KPP-ës, ka vendosur që të pandehurit ti obligojë që veç e veç të paguajnë paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzet- euro), si dhe shumën prej **30 €** (tridhjetë-euro) për kompensimin e viktimave të krimit, pas ditës pasuese të plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
P.nr.758/2023,
me datë 05.03.2024

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Veli Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej **30 ditëve** nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Gjilan.